



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 6922/Prot.
10

Tiranë, më 27.01. 2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 5 , datë 27/01 2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Korsel" shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim, në procedurën e prokurimit: Loti II, me objekt: "*Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tiranë II*" me fond limit 548.694.815 lekë pa tvsh, të zhvilluar nga Bashkia Tiranë, në datë 25.01.2021.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Korsel" Shpk me NIPT J64104124G, me adresë: Rruga e Durrësit, Pallati 144/1 Tiranë.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Korsel" shpk, ka nisur bazuar në Vendimin Nr. 264/2021 Prot., datë 08.06.2021 të Komisionit të Prokurimit Publik, me të cilin ky i fundit i ka propozuar APP, nisjen e hetimit administrativ për operatorin ekonomik "Korsel" Shpk, për konstatimet e bëra në këtë vendim.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e nenit 78/1/a të LPP.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 5, datë 27. 01.2022, APP ka vendosur të përjashtojë për 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, operatorin ekonomik "Korsel" Shpk me NIPT J64104124G, nga e drejta për të fituar kontrata publike, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Në marrjen e këtij vendimi, APP vlerëson rrethanat lehtësuese për operatorin ekonomik "Korsel" faktin se, nuk ka qenë i përjashtuar më parë dhe nuk ka përfituar fonde publike, pasi është skualifikuar.